

FORUMI për SIGURI

Reagimet në situata emergjente - përgatitjet dhe mundësitë

Prishtinë, maj 2013

**FORUMI PËR INICIATIVA QYTETARE (FIQ), INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
(IKD), INSTITUTI GAP, dhe INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE (INDEP)**

Mirënjohje

Kjo analizë është shkruar nga Arieta Rexhepi nga Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), anëtar i Forumit për Siguri (FS), me kontributin e anëtarëve tjerë të FS. Ndërkaq, zhvillimin e intervistave në komuna e ka bërë Albion Sherifi nga Nisma për Aktivizim.

Punimi është realizuar me përkrahje të Ballkan Trust for Democracy (BTD).

© Të drejtat autoriale

Asnjë pjesë nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo të ndryshohet pa lejen e botuesit.

Mendimet e shprehura me shkrim apo në publikimet elektronike janë të Forumit për Siguri dhe nuk përfaqësojnë domosdo pikëpamjet e donatorit.

Përmbajtja:

- Hyrje.....5
- Metodologjia.....6
- Kuadri ligjor ekzistues dhe gjendja e kapaciteve reaguese nga niveli qendror....7
- Kapacitetet e komunave për reagime në situata emergjente – Gjetjet nga komunat.....10
- Plani për Vlerësimin e Rreziqeve i Komunës së Gjilanit.....11
- Rast studimor – Restelica.....13
- Rekomandime.....15
- Ligjet dhe strategjitë e konsultuara.....16

Shkurtesat

SIME - Sistemi i Integruar Menaxhimit te Emergjencave

PRK - Plani i Reagimit Kombëtar

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

IME - Instituti i Menaxhimit Emergjent

FSK - Forca e Sigurisë së Kosovës

PK - Policia e Kosovës

AME - Agjencioni për Menaxhim Emergjent

QO - Qendrat Operative

Hyrje

Emergjencat përbëjnë situatë serioze, të papritur dhe zakonisht të rrezikshme që kërkon veprim të menjëhershëm e që kryesisht vijnë nga fatkeqësitë, që nënkuptojnë dukurinë e shkaktuar nga fuqitë e pakontrolluara natyrore dhe nga fuqi të tjera, që e rrezikojnë jetën apo shëndetin e njerëzve, të shtazëve si dhe pasurinë, që shkaktojnë dëme në trashëgiminë e kulturës dhe të natyrës, si dhe në mjedis në atë masë që për kontroll dhe për mbizotërim është e nevojshme të përdoren masat, forcat dhe mjetet e posaçme¹. Me emergjenca potencialisht mund të përballet dhe është i rrezikuar çdo vend, pavarësisht pozitës gjeografike. Juridiksione të ndryshme, përkufizojnë në forma të ndryshme emergjencat dhe secili shtet me ligje, rregullore dhe strategji, rregullon këtë fushë, respektivisht ndërhyrjet në rastet emergjente.

Çdo shtet duhet t'i jep prioritet fushës së emergjencave, duke pasur parasysh se parandalimi në të shumtën e rasteve rezulton në zvoglimin e fatkeqësive. Përveç kuadrit ligjor, prioritet në këtë rast do të duhej t'i jepet edhe shtimit të kapaciteteve njerëzore dhe teknike.

Kosova nuk bën përjashtim në këtë dimension të rregullimit me strategji dhe ligje të kësaj problematike. Me një kuadër të konsoliduar ligjor, institucionet përgjegjëse kanë nxjerrë edhe dy strategji lidhur me situatat emergjente, e që përfshihen në: "Sistemi i Integruar i Reagimit ndaj Emergjencave" dhe "Plani i Reagimit Kombëtar". Veç rregullimit në nivel kombëtar, disa komuna kanë hartuar edhe plane komunale të reagimit ndaj emergjencave të ndryshme, plane komunale të operacioneve emergjente këto që sipas PRK², komunat i aktivizojnë sipas nevojës.

Jo rrallëherë, komuna të ndryshme të Kosovës, janë përballë me situata emergjente, nga të cilat kanë humbur jetë njerëzish dhe janë dëmtuar prona e paluajtshme. Zingjiri i komunikimit në raste emergjencash, sipas strategjive dhe ligjeve në fuqi, jo rrallëherë ka patur ndikimin e tij negativ. Ky zingjir poshtë-lart, i komunikimit, është aq kompleks, sa ndikon edhe në kohën e reagimit ndaj emergjencave. E kjo, sidomos kur merret parasysh se Kosova deri tani, edhe pas planifikimit të hapjes së qendrave të operimit për emergjenca ³, nuk disponon me këto qendra, të cilat, këtë komunikim ani pse kompleks, do ta lehtësonin dukshëm.

¹ Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 02/L-68;

² PRK, shtojca 4, pika 2, fq. 70

³ Qendrat e Operimit janë paraparë me SIME-n, 2010

Orteku i borës, që kushtoi me jetë njerëzish në fshatin Restelicë (2011); tërmeti në Gjilan, me shkallë të rihterit 5,2 (2002); zjarri në Bjeshkët e Deçanit (2012); vërshimet në komunën e Pejës (2013), janë vetëm disa nga shembujt ku vendi jonë është ballafaqur me situata emergjente. Nisur nga kjo, FIQ (Forumi për Siguri), ka për qëllim të analizoj dhe vështroj gjendjen aktuale lidhur me kapacitetet e komunave për intervenime në raste emergjente, qoftë kuadrin ligjor, qoftë kapacitetet teknike dhe njerëzore, me të cilat disponojnë institucionet relevante dhe hapjen e debatit mbi përgatitjen e vendit tonë për menaxhimin e emergjencave. Kur kësaj i shtohet edhe mungesa e analizave të kësaj problematike qoftë nga institucionet, qoftë nga mekanizmat tjerë joqeveritar, ne e konsiderojmë të nevojshme vështrimin e kapaciteteve institucionale dhe nevojave të institucioneve relevante për reagime në situata emergjente.

Metodologjia

Ky hulumtim është realizuar duke analizuar ligje dhe strategji të cilat rregullojnë menaxhimin e situatave emergjente; pra me anë të kërkimeve cilësore dhe realizimin e gjithsej 13 intervistave me përfaqësues të institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Kuadri ligjor ekzistues dhe gjendja e kapaciteve reaguese nga niveli qendror

Sa i përket kuadrit ligjor të deritashëm, institucionet e sigurisë të Republikës së Kosovës, kanë miratuar numër të konsiderueshëm strategjish ⁴ dhe plane të veprimit për situatat emergjente. Përveç institucioneve qendrore, edhe disa komuna kanë miratuar plane të veprimit ⁵ për reagim në raste të situatave emergjente.

Sa i përket kuadrit ligjor për çështje emergjencash, Kosova këtë fushë e ka të rregulluar me një mori ligjesh e rregulloresh, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e deri te ligjet specifike. Me 22 prill 2010 Kryeministri i Republikës së Kosovës ka lëshuar vendimin (me nr. ref. 685/10), i cili ka urdhëruar zëvendësministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të themeloj Sistemin e Integruar për Menaxhimin e Emergjencave. ⁶ Ky sistem ofron kornizë të qëndrueshme gjithëkombëtare për të mundësuar që qeveritë e të dyja niveleve, organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe sektori privat, të punojnë së bashku për parandalimin, mbrojtjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zvogëlimin e efekteve të incidenteve pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tyre. Kjo qëndrueshmëri ofron bazament për përdorimin e sistemit për të gjitha incidentet, duke filluar nga ndodhitë e përditshme deri tek incidentet që kërkojnë reagim të koordinuar qeveritar. ⁷

Përveç SIME-s, MPB, ka hartuar edhe Planin e Reagimit Kombëtar, plan ky që përfshinë të gjitha llojet e rreziqeve, duke pasur për qëllim qasjen gjithëpërfshirëse kombëtare për menaxhimin e emergjencave, me parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje.

Edhe pse incidentet zakonisht fillojnë dhe përfundojnë në rrafshin lokal dhe menaxhohen mbi baza ditore në nivelin më të ulët të mundshëm gjeografik, organizativ dhe juridiksional, prap se prap, ekzistojnë rrethana në të cilat operacionet e suksesshme të menaxhimit të incidentit varen nga përfshirja e shumë juridiksioneve, niveleve të qeverisjes, agjencive funksionale dhe disiplinave të shumta të reagimit emergjent. Këto rrethana kërkojnë koordinim efektiv dhe

⁴ Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave, 2010; Plani i Reagimit Kombëtar, 2010; Ligji për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi Tjera (nr.2006/02/L-68), Ligji për Mbrojtje nga Zjarri (nr. 2006/02-L41), Ligji për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L045; Ligji për Policinë Nr. 03/L-035; 9. Ligji për Transportin rrugor Nr. 2004/1; Ligji për Shëndetësi Publike Nr. 02/L-78; Ligji për Kujdesin Shëndetësor Emergjent Nr.2006/02-L50;

⁵ Plani I Vlerësimit të Rrezikut për Komunën e Gjilanit, 2012; Vlerësimi I rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e Prishtinës, 2009; Plani I mbrojtjes nga Zjarri, KK Prishtinë, 2011

⁶ Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë, 2010, fq.8

⁷ Po aty

efikas midis këtij spektri të gjerë të strukturave dhe aktiviteteve.⁸ Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, rregullon në mënyrë shumë komplekse, çështjen e menaxhimit të emergjencave. Mund të themi lirisht, që kompleksiteti i këtij dokumenti, mund të arrij deri te konfuzimi i institucioneve të ndryshme, e sidomos komunave, të cilët janë reaguesit e parë në rastet emergjente. Lidhur me këtë, do të ishte i nevojshëm një dokument tjetër që e zbërthen SIME-n. Kur kemi parasysh edhe natyrën e objektit të shtjellimit që bën SIME, atëherë, zbërthimi i tij me dokumente tjera, do të ishte shumë i nevojshëm.

Komunat e ndryshme të Kosovës, janë përballur me situata emergjente, ku zingjiri i komunikimit, i paraparë në SIME, nuk është respektuar. Nisur nga kjo, zbërthimi i mëtejshëm, i ndarë në kategori emergjencash, do të rezultonte me respektimin e zingjirit të komunikimit. Meqë ngjarjet emergjente fillojnë në nivel komune, do të thotë se përgjegjësia bie mbi komunën, e nëse eskalon situata, atëherë kompetencat tejkalojnë në qendra rajonale. Nëse situata tejkalon edhe nivelin e përgjegjësisë dhe mundësisë për veprim të rajonit të caktuar, atëherë kërkesa shkon në nivel të Agjencisë për Menaxhim të Emergjencave. Nëse përmbushen elementet e parapara me ligj, Ministria për Punë të Brendshme i jep propozim Kryetarit të shtetit, e ky i fundit vlerëson nëse duhet shpallur gjendjen e jashtëzakonshme ose në të kundërtën e kthen kërkesën për menaxhim nga MPB. Në raste të caktuara emergjencash, ka pasur shkelje drastike në këtë komunikim dhe format e intervenimit. Duke u nisur nga kjo, MPB dhe institucionet tjera relevante, duhet të rishikojnë qoftë zingjirin e komunikimit, qoftë nevojën për trajnime të zyrtarëve që janë përgjegjës për këtë problematikë dhe interpretimin e detajuar të SIME-s dhe Planit të Reagimit Kombëtar, që është atribut i SIME-s, e që është plan gjithëpërfshirës dhe unifikues. Lidhur me këtë, vlen të theksohet se parashihet edhe formimi i Institutit të Menaxhimit të Emergjencave, i cili është përgjegjës për lehtësimin e zhvillimit dhe adaptimit të standardeve, udhëzimeve dhe protokolleve të nivelit kombëtar të lidhura me SIME-në.⁹ Ky institut do të mund të luante edhe rolin e interpretuesit të PRK-së dhe SIME-s, përsëri duke pasur parasysh kompleksitetin ¹⁰ e këtyre dokumenteve dhe trajnimet e pamjaftueshme të zyrtarëve që drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë përgjegjësitë e caktuara në raste emergjente, e që

⁸ Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë, 2010, fq. 10

⁹ PRK, fq. 55

¹⁰ "Kompleksiteti i Planit të Reagimit Kombëtar nuk rrjedh vetëm për shkak të përmbajtjes që ai ka si Plan mirëpo për zbatimin e këtij plani është i nevojshëm një vetëdijësim i autoriteteve lokale si reagues fillestarë, të cilët duhet të njohin më mirë këtë plan si dhe të punojnë edhe me popullatën lokale për veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme në raste krizash". Nga intervista e FIQ me Nënkolonel Hysen Gecaj, FSK

mungesa e këtyre trajnimeve në të kaluarën ka rezultuar me shkeljen e dispozitave, rregulloreve dhe planeve të reagimit. IME, që nga planifikimi i krijimit nga PRK, në vitin 2010, nuk është krijuar ende.¹¹

Pavarësisht asaj që u tha më lart, në lidhje me kompleksitetin e dokumenteve, respektivisht SIME dhe PRK, sa i përket rregullimit teorik të fushës së emergjencave, deri diku mund të jemi të kënaqur. Çka duhet t'i shqetësoj institucionet relevante, është gjendja në terren dhe rreziqet që mund të na kanosen si pasojë e ndonjë situatë të mundshme emergjente.

Kur jemi te gjendja aktuale në terren, sa i përket kapaciteteve qoftë njerëzore, qoftë logjistike e operacionale, këtu padyshim që ka shumë vend për punë dhe mjete financiare.

- Edhe pas planifikimit të krijimit Qendrave Operative (që tash për tash luajnë rolin e qendrave dispeçerike ¹²) dhe nevojës së padiskutueshme për ekzistimin e tyre, këto qendra mirëfilli nuk janë krijuar ende.
- Sistemi i alarmimit ¹³ nëpër komuna nuk është funksional
- Me iniciativën e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është krijuar një rezervë shtetërore me ushqime dhe mjete elementare për jetesë, por edhe kjo është modeste. ¹⁴
- Problem që është evidentuar, janë edhe trajnimet ¹⁵ e pamjaftueshme që u ofrohen zyrtarëve kompetent dhe që rezultojnë me koordinim jo të duhur në raste emergjente.
- Nga viti 2008, ligji ka obliguar drejtorin e përgjithshëm të policisë që të formoj policinë rezervë, e cila do të kushtonte financiarisht vetëm në krijimin e saj (uniformimi dhe pajisja me mjetet e duhura) dhe më pas kostoja e saj vjen në shprehje vetëm kur përballemi me ndonjë situatë apo dërgohen në stërvitje dhe trajnime. Policia rezervë është duke u planifikuar të krijohet, sipas zyrtarëve të MPB-së, por deri tani edhe kjo ka mbetur në letër, për shkaqe financiare.¹⁶

¹¹ Intervistë e FIQ me z. Alush Beqiri, Drejtor i Departamentit për Parandalim, AME

¹² Intervistë e FIQ me zv.ministrin e MPB-së, z. Ismet Ibishi

¹³ "Në një takim me Asociacionin e Komunave kam kërku që urgjentisht këto sisteme të alarmimit të aftësohen në cdo qytet, gjë që kanë funksionu edhe më herët." Intervistë e FIQ me zv.ministrin e MPB-së, z. Ismet Ibishi

¹⁴ Intervistë e FIQ me zv.ministrin e MPB-së, z. Ismet Ibishi

¹⁵ "Falë trajnimeve të UNDP-së, Dragashi dhe Peja, kanë avancu shumë në implementimin e PRK-së", Intervistë e FIQ me zv.ministrin e MPB-së, z. Ismet Ibishi

¹⁶ Intervistë e FIQ me zv.ministrin e MPB-së, z. Ismet Ibishi

- Çështje tjetër që nuk i është dhënë prioritet është edhe flota ajrore, që sipas zyrtarëve të MPB-së, janë krijuar kushtet për të, siç janë pilotët, stafi administrativ, marrëveshja me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, tash e dhjetë muaj, mirëpo mungon nënshkrimi i Kryeministrit të Kosovës për blerjen e dy helikopterëve.¹⁷
- Buxheti i ndarë për çështje të situatave emergjente, është shumë simbolik, andaj edhe problemet e lartcekura, vijnë nga buxheti i pamjaftueshëm që ndahet për këtë sferë.

Kapacitetet e komunave për reagime në situata emergjente - gjetjet e hulumtimit nëpër komuna të ndryshme¹⁸

Gjatë këtij hulumtimi u vërejtën mangësi në aspektin strukturor dhe organizativ të drejtorive komunale të kësaj fushe¹⁹. Problemi fillestar konsiston në ndarjen e sektorëve në drejtori, ku shumica e drejtorive për mbrojtje dhe shpëtim veprojnë nën kuadrin e Drejtorisë Komunale për Shërbime Publike.

Çështje tjetër e gjetur e këtij hulumtimi janë edhe asetet/njësitë nën udhëheqjen e këtyre drejtorive, rast psh. njësitë të zjarrëfikësve, të cilët ndonëse me ligjin e ri, kanë kaluar nën kompetencë të MPB-së, ato ende shfrytëzojnë fondet e pakëta komunale për investime në fushën e tyre.

Aktivitetet të cilat zhvillohen nga komunat në raste emergjencash, apo si parapërgatitje për to kryesisht janë të njëjta, që nënkuptonin trajnime/aftësim dhe planifikime.

Pothuajse të gjitha komunat kanë të miratuara Planin e Vlerësimit të Rrezikut – obligativ sipas ligjit dhe disa prej tyre hasnin në vështirësi në implementimin e tij për shkak të implikimeve buxhetore dhe mungesës së burimeve njerëzore.

Detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Plani Kombëtar i Reagimit dhe Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave përgjithësisht zbatohen, porse ka paqartësi në funksionimin e vijës

¹⁷ Intervistë e FIQ me zv.ministrin e MPB-së, z. Ismet Ibishi

¹⁸ Gjetjet janë nxjerrë nga 13 intervistat nëpër komuna të ndryshme; emrat e të intervistuarve janë në fund të këtij hulumtimi

¹⁹ Diku: Drejtori të Shërbimeve Publike dhe Emergjencë; Diku: Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;

hierarkike, gjegjësisht koordinimit ndërmjet institucioneve, dhe natyrisht problemet buxhetore për realizimin/zbatimin e tij.

Shumica e Drejtorive për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, deklaruan se posedojnë pajisje teknike, makineri, porse pothuajse të gjithë konkludonin se ato pajisje janë të pakëta, të amortizuara dhe është e nevojshme të investohet në blerjen e tyre.

Ky hulumtim ka nxjerrë si përfundim se nuk ka buxhet të planifikuar për sektorin e emergjencave, pasi buxheti është për gjithë drejtorinë në linjën buxhetore të mallrave dhe shërbimeve - pagave/mëditjeve, dhe për të ndihmuar në këto situata përdoren subvencionet komunale, si dhe gatishmëria e bizneseve lokale etj. Investimet institucionale në dhjetë komuna ku është zhvilluar hulumtimi janë të vogla, kryesisht në infrastrukturën bazike dhe pajisje përcjellëse elementare, porse falë donacioneve të organizatave ndërkombëtare, dhe disa shteteve, është ndihmuar me makineri dhe pajisje të tjera në funksionimin e këtyre sektorëve në komuna.

Nevojat për investime tjera janë të karakterit kapital, infrastrukturor dhe teknik, kërkesë kjo e shumicës së komunave të intervistuar.

Problem që u has në funksionimin e këtyre sektorëve është numri i pamjaftueshëm i punëtorëve, si atyre administrativ, por edhe të tjerë. Kjo edhe pengon efikasitetin e punës së këtyre sektorëve.

Bashkëpunimet janë një komponentë e rëndësishme në këto situata, në të cilat këto drejtori kanë bashkëpunëtorët e tyre lokal, si Policinë e Kosovës, FSK, OSBE, shkollat, spitalet etj.

Bashkëpunimi me nivelin qendror është i karakterit të shkëmbimeve të informacioneve, planeve, por edhe aftësim të stafit që organizohet nga niveli qendror, gjegjësisht AME-ja.

Trajnimet janë të vazhdueshme për të gjithë stafin nëpër komuna, për të cilën mund të themi se kanë arritur aftësimin e tyre profesional në menaxhimin e situatave emergjente.

Komitetet e shpëtimit si struktura komunale, janë përgjithësisht funksional/aktiv vetëm gjatë ndodhjes së ndonjë fatkeqësie natyrore apo tjetër, pra nuk janë komitete të cilat bëjnë në baza ditore planifikime, evidentime dhe survejime në fushën e emergjencave.

Komunat ²⁰, me përjashtim të komunës së Obiliqit, kanë përfituar pothuajse të gjitha nga bashkëpunimet ndërkombëtare dhe programet e ngjashme, kryesisht donacione në makineri, pajisje elementare dhe pajisje tjera përcjellëse.

Rreziqet tipike natyrore ²¹ në Kosovë është konkluduar të jenë: vërshimet, orteqet, rrëshqitjet e dheut, erërat, tërmetet, radioaktiviteti, zjarret malore dhe fushore etj.

Shembull: Plani për Vlerësimin e Rreziqeve i Komunës së Gjilanit ²²

Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në vitin 2012, sigurisht pas vlerësimit të nevojave dhe rëndësisë së preventivës, ka hartuar Planin e Vlerësimit të Rrezikut. Ky plan i detajuar, përfshinë informata të duhura qoftë demografike, infrastrukturore, e deri te vlerësimet e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Vlerësimet e rrezikshmërisë janë bërë për këto kategori, sigurisht që janë parë potencialisht më të mundshme: zjarret malore-fushore, vërshimet, shtrëngatat dhe breshëri, tërmetet, erozionet, thatësitrat, fatkeqësitë tekniko-teknologjike, rrezikshmërinë për transportin rrugor, vlerësimin e rrezikshmërisë për epidemi etj.

Të gjitha këto vlerësime, në këtë plan janë bërë me detaje, duke përfshirë lokacionet, numrin e banorëve, sipërfaqen e mundshme të vërshimeve, strehimoret dhe resurset për angazhim; të gjitha këto informacione të vlefshme dhe të nevojshme në raste emergjencash. Veç tjerash, ky plan, përmban edhe skenarë të mundshëm të ngjarjeve dhe situatave emergjente. Nga ky plan, vlen të theksohen edhe masat e parapara të parandalimit, të cilat ndahen në këto kategori (po përmendim vetëm disa nga më kryesoret):

Masat parandaluese për zjarret malore-fushore (ku hyjnë edukimi qytetar; lëvrimi i sipërfaqeve tokësore pas korrje shirjeve; ndarja e sipërfaqeve me kultura gjatë fushatës së korrje shirjeve; tampon zona; ndalimi i ndezjeve të zjarreve pa leje paraprake si dhe sanksionimi i këtyre veprimeve);

²⁰ Dhjetë komunat, zyrtarët e të cilëve janë intervistuar, e që i gjeni në fund të këtij hulumtimi

²¹ Sipas zyrtarëve komunalë dhe sipas planeve të vlerësimit të rrezikshmërisë

²² Prezantimi në pika të shkurta I këtij plani është bërë me qëllim të dhënies së një shembulli të mirë, që do të duhej ta ndiqnin komunat të cilat kanë plane më pak të detajuara, e sidomos komunat të cilat deri më tash nuk kanë bërë plane të vlerësimit të rrezikut. Gjatë hulumtimit, poashtu kemi hasë në komuna (psh Komuna e Pejës), që sipas zyrtarëve të tyre, shprehen se kanë plane, mirëpo janë plane interne dhe nuk i publikojnë.

Masat parandaluese për vërshimet (reduktimi i përmytjeve në zonat e ndikuara nga përmytjet, duke ndërmarrë masa teknike: përmirësimi i shtratit të lumenjve; rregullimi i sistemit të drenazhimit; kufizimi i zhvillimeve në zonat të cilat janë të prira për përmytje);

Masat parandaluese për tërmetet (aplikimi i kodit të ndërtimit dhe respektimi i rregullave bazë; organizimi i fushatave periodike për vetëdijësimin e popullatës për rreziqet nga tërmetet; analizat inxhinierike dhe hapësinore për ndërtesat kritike dhe shfrytëzimi i tyre në rast fatkeqësie);

Masat parandaluese për rrezikun nga gripet dhe epidemitë (evakuimi dhe strehimi i popullsisë së atakuar; sigurimi i ujit të pijshëm dhe ushqimit; informimi me kohë dhe i saktë i popullatës).

Restelica – rast studimi

“Në Restelicë, kemi mundur të shohim gjithçka përpos mënyrës institucionale të menaxhimit të asaj situate, siç e parasheh Plani i Reagimit Kombëtar”, është shprehur zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Ismet Ibishi në intervistën për FIQ, për këtë hulumtim.

Më 11 shkurt 2012 në fshatin Restelicë, komuna e Dragashit, kishte ndodhur një fatkeqësi, ku si rezultat i lëvizjes së një orteku të fuqishëm të borës erdhi deri te shkatërrimi i 15 shtëpive, të mbuluara tërësisht nga orteku i borës, ku dy prej tyre ishin të banuara me 11 anëtarë të familjes Reka, ku humbën jetën 10 persona. Situata që ishte krijuar kërkoi domosdoshmërinë dhe urgjencën e reagimit të kërkim-shpëtimit, si dhe marrjen e masave për minimizimin apo eliminimin e pengesave që kishin ardhur nga orteku i borës. Përveç dëmit të pariparueshëm, pra humbjes së jetëve, dëmi material në këtë rast ishte gjysmë milion euro.

Natyra e fatkeqësisë

Sipas raporteve, institucionet (PK, FSK dhe Komuna e Dragashit), fatkeqësinë e kanë përshkruar si fatkeqësi natyrore, e krijuar nga të reshurat e mëdha të borës, duke dhënë informacione të ndryshme nga njëra-tjetra, sa i përket dëmtimeve dhe numrit të personave të atakuar nga fatkeqësia; ku sipas PK-së, janë dëmtuar 15 shtëpi dhe nën to kanë mbetur 11 persona, përderisa komuna raporton për 5 shtëpi të rrafshuara dhe 14 të tjera të dëmtuara

dukshëm. Në këtë rast, FSK-ja nuk ka dhënë ndonjë informacion rreth shifrave të shtëpive dhe banorëve të atakuar nga fatkeqësia.

Mos-efikasiteti i institucioneve në informim, veprim dhe koordinim institucional në Restelicë

Edhe këtu, të tri institucionet (PK, FSK dhe Komuna e Dragashit), sipas raporteve të tyre, kanë pasur vonesa në informim. Kjo padyshim ka pasur ndikim edhe në veprimin me vonesë të tyre. Ndërkaq, si shkak i pengimit të tyre për mosveprim të shpejtë, të tri institucionet arsyetohen me borën e madhe, ku Komuna e Dragashit, fajëson edhe mospastrimin e rrugës nga kompania e kontraktuar prej saj.

Duket që edhe sa i përket koordinimit institucional në menaxhimin e kësaj fatkeqësie, ka pasur ngecje të dukshme, situatë kjo që ka pasuar me probleme në menaxhim të përbashkët të situatës, dhe e gjithë kjo arsyetohet me mosnjohjen e kompetencave dhe përgjegjësi.

Zbatimi i Planit të Reagimit Kombëtar në rastin e Restelicës

Si pasojë e mungesës së Komandës së Incidentit, PRK-ja nuk është zbatuar sa duhet. Si arsyetim i institucioneve relevante për moszbatimin e PRK-së është mosinformimi i disa zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e emergjencave lidhur me planin dhe mostrajnimi i tyre për reagime emergjente.

Problemet tjera në Restelicë

Lëvizja e pakontrolluar dhe e pakoordinuar e qytetarëve ka shkaktuar vonesa për institucionet relevante. PK-ja megjithë mundësitë për ndalesa të automjeteve private, nuk e ka bërë këtë. Vizitat e delegacioneve të shtetit, poashtu ishin përveç të panevojshme në këtë rast, rezultuan me shkaktim të tollovisë nëpër rrugët edhe ashtu jo shumë funksionale të mbuluara nga bora e madhe.

Vlen të theksohet se sipas banorëve, ka qenë i ndaluar ndërtimi i shtëpive në Restelicë, sepse çdo shtëpi është e rrezikuar dhe qytetarët duhet të ndërgjegjësohen dhe t'i binden këtij konstatimi, duke pasë parasysh rrezikshmërinë.

Rekomandimet

- Zbatimi në mënyrë të plotë i Ligjit mbi Fatkeqësitë Natyrore, dhe i dokumenteve strategjike: SIME dhe PRK;
- Trajnimi i zyrtarëve përgjegjës për reagime në situata emergjente, sidomos në aspektin e koordinimit, si në nivel lokal poashtu edhe në nivel qendror;
- Rritja e buxhetit për institucionet relevante dhe njësiteve që merren direkt me situata emergjente;
- Qartësimi i kompetencave të nivelit lokal dhe qendror;
- Formimi i Qendrës Operative Nacionale dhe formimi në çdo komunë i Qendrave Operative Emergjente;
- Formimi i IME; i cili është i nevojshëm dhe do të rregullonte protokollet, standardet dhe do të bënte hulumtime të ndryshme në lidhje me çështjet emergjente;
- Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve, duhet të jetë prioritet qoftë i institucioneve lokale, qoftë i atyre qendrore, duke pasur parasysh rëndësinë e prevenimit të situatave emergjente;
- Krijimi i standardeve operative unifikuese;
- Funkcionalizimi i Sistemit të Alarmimit;
- Të bëhen ndryshime në PRK dhe SIME, në mënyrë që përdorimi i tyre të jetë më praktik, e sidomos pjesa e komunikimit poshtë-lart të thjeshtohet;
- Kompletimi i flotës ajrore, duhet të jetë prioritet i institucioneve të Kosovës, respektivisht i Qeverisë së Kosovës;
- Blerja e mjeteve të nevojshme dhe pajisja e trupave që janë përgjegjës për intervenime në situata emergjente me këto mjete;
- Rritja e rezervave ushqimore shtetërore, për raste emergjencash;
- Institucionet relevante duhet të bëjnë skenare të supozimit dhe veprimit ²³

²³ Zv.ministri i MPB-së, z. Ismet Ibishi, shprehet se "Kam kërkuar nga Agjensioni i Menaxhimit të Emergjencave të hartoj plan të ushtrimit nga niveli lokal deri te niveli regjional me supozime dhe me veprime, por për shkaqe të kostos kanë mbetë pa u realizuar". Në ndërkohë që Drejtori për Parandalim i AME-së, z. Alush Beqiri, shprehet se "AME ka bërë skenare për zjarr, vërshime, tërmete; për zjarr dhe vërshime janë bërë edhe ushtrime praktike, ndërsa për tërmete jo."

Ligjet dhe strategjitë e konsultuara

1. Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave
2. Plani i Reagimit Kombëtar
3. Ligji për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi tjera Nr.2006/02/L-68
4. Ligji për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr.2008/03-L045;
5. Ligji për Policinë Nr. 03/L-035;
6. Plani i Vlerësimit të Rrezikut për Komunën e Gjilanit;
7. Artikuj të tjerë

Intervistat e realizuara:

1. Ismet Ibishi, zv/ministër i Ministrisë për Punë të Brendshme
2. Alush Beqiri, drejtor i Departamentit për Parandalim, Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave-MPB
3. Hysen Gegaj, nënkolonel, Forca e Sigurisë së Kosovës
4. Ibush Kelmendi, shef i Sektorit të Emergjencave, Prishtinë
5. Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë - Kaçanik
6. Avdyll Lajqi, drejtor i Drejtorisë për Emergjencë dhe Haxhi Krasniqi, zyrtar - Pejë
7. Xhevat Rraci, drejtor i Drejtorisë Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe Gëzim Efendija, zyrtar, Gjakovë
8. Blerton Ajeti - drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim - Gjilan
9. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Podujevë
10. Merita Besimi, zyrtare, Prizren
11. Imer Berisha, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Obiliq
12. Haki Mehmetaj, zyrtar, Deçan
13. Bedri Hasani, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave Civile, Istog